


Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid



Raport Muaji Tetor 2024

Fondi Furnizues Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit
Administrimi i Fondit
Monedha
Datë Lancimi
Vlera fillestare e kuotës
Shuma minimale e investimit
Shuma fillestare minimale per plan investimi
Fondi Kryesor ku investon
Vlera Neto e Aseteve
Cmimi i kuotës
Banka depozitare
Banka nëndepozitare
Numri i Investitorëve
Horizonti minimal i rekomanduar i investimit

**Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid – Fond Furnizues
Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a**

Euro
07 Maj 2024
100
€ 500
€ 50
Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide – ISIN AT0000A1YC10
€ 1,224,770
102.6179
Banka e Pare e Investimit, Albania
Raiffeisen Bank International, Austria
57
5 vjet

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje
Tarifë në dalje
Tarifë administrimi vjetore
Tarifa te tjera te vazhdueshme

0.00%
1.00% për çdo tërheqje përpara periudhës 2-vjeçare të investimit
Deri në 1.30% në vit
Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj
bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregulator apo kostot për
komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Maksimum 3.5% në vit
Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe bankes depozitares.

Total Komisione/tarifa të vazhdueshme
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave
Kosto të transaksioneve

Objektivi dhe Politika e investimit e Fondit Furnizues


Objektivi i Fondit Furnizues është t'ju mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide, i cili synon krijimin e të ardhurave të rregullta në një periudhë afatmesme.

Fondi Furnizues investon në kuotat e Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide të paktën 85% te asetëve. Jo më shumë se 15% e asetëve do të investohen në instrumente si depozita bankare afatshkurta, marrëveshje të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, cash apo ekuivalentë të tij.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë
Potencial Përfitimi më i lartë



Profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues është i lidhur ngushte me profilin e riskut të Fondit Kryesor. Bazuar në të dhënat historike të kthimeve të Fondit Kryesor gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues i përket kategorisë 3 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRRI=3).

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Fondi Kryesor Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit
Administrimi i Fondit
Monedha
ISIN
Tarifë në hyrje
Tarifë në dalje
Tarifë administrimi vjetore
Rabat i paguar Fondit Furnizues

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid
Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H, Austria
Euro
AT0000A1YC10
0.00%
0.00%
0.50%
0.306% në vit

Politika e Investimit

Fondi Kryesor është një Fond miks që investon në tituj, emetuesit e të cilëve janë klasifikuar si të qëndrueshëm në bazë të kriterëve sociale, mjedisore dhe të qeverisjes (pa marrë parasysh investimet në fonde investimi, instrumentet derivative dhe depozitat). Sipas këtyre kriterëve, nuk investohet në sektorë të caktuar, të tillë si prodhimi i armëve, inxhinieria gjenetike e gjelbër/bimëve, në kompani që shkelin të drejtat e punës dhe të njeriut, ose që janë të përfshira në korrupsion dhe manipulim të pasqyrave financiare, në shtete me regjime autoritare, ku shkelet liria e medias dhe shtypit, apo që nuk janë pjesë të marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike apo kanë problematika të lidhura me pastrimin e parave.

Fondi Kryesor e ka kufizuar investimin në aksione deri në 30% të asetëve të tij. Të paktën 51% e asetëve të Fondit Kryesor investohen drejtpërdrejt në tituj. Emetuesit e obligacioneve ose instrumenteve të tregut të parasë në Fond mund të jenë, ndër të tjera, shtetet, organizatat supra kombëtare dhe/ose kompanitë. Fondi Kryesor mund të investojë më shumë se 35% të asetëve në tituj borxhi të emetuar nga qeveria e Austrisë, Gjermanisë, Belgjikës, Finlandës, Francës ose Holandës.

Fondi Kryesor mund të investojë në instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit, me qëllimin për të zbutur risqet dhe për të arritur objektivat e politikës së investimit.


Struktura e Portofolit të Investimit në 31 Tetor 2024

Fondi Furnizues ka investuar 98.23% të aktiveve të tij në Fondin Kryesor në 1 tetor 2024.


Duke marrë parasysh strukturën e portofolit të investimeve të fondit Kryesor më 31 tetor 2024, për fondin Furnizues alokimi në aksione është 19.3% dhe alokimi në instrumentet me të ardhura fikse është 79.3%.

Vlerësimi mesatar i riskut të kreditit është A për investimet në obligacione të fondit Kryesor. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve ishte 3.33% për një kohëzgjatje mesatare prej 5.08 vitesh në 31 tetor për fondin Furnizues.

Sipas instrumentave financiare



Sipas klases se asetëve



Investimet Top 10 – Fondi Kryesor

CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 2 7/8 05/25/27	1.73%
REPUBLIC OF AUSTRIA RAGB 0.9 02/20/32	1.01%
COUNTRY OF SCHLESWIG-HOLSTEIN SCHHOL 2 7/8 05/30/34	0.87%
CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 0 1/8 09/15/31	0.86%
LAND OF LOWER AUSTRIA NIEDOE 3 1/8 10/30/36	0.85%
FEDERAL REPUBLIC OF GERMANY DBR 4 01/04/37	0.84%
SPAREBANK 1 BOLIGKREDITT SPABOL 0.01 09/22/27	0.73%
EUROPEAN UNION EU 0 07/04/31	0.71%
LAND OF HESSEN HESSEN 2 1/2 10/01/31	0.70%
KFW KFW 3 1/4 03/24/31	0.70%

Info per Obligacionet – Fondi Kryesor

Ø Kohëzgjatja	5.17
Ø Kohëzgjatja e modifikuar	5.02
Ø Yield në % (në maturim)	3.59
Ø Yield në % (Next call)	3.39
Ø Norma e kuponit në %	2.37

Investime ne Aksione top 10 - Fondi Kryesor

NVIDIA Corp	0.96%
Microsoft Corp	0.94%
Apple Inc	0.81%
Alphabet Inc	0.60%
Merck & Co Inc	0.31%
Eli Lilly & Co	0.31%
Procter & Gamble Co/The	0.30%
Motorola Solutions Inc	0.28%
Ecolab Inc	0.27%
Novo Nordisk A/S	0.27%

Performanca e Fondit Furnizues

Fondi Furnizues ka shënuar një ecuri negative mujore prej **-0.25%** gjatë muajit tetor.

Tetori ishte një periudhë sfiduese për obligacionet dhe shumica e tregjeve kryesore të obligacioneve qeveritare pësuan rënie gjatë muajit, pasi një fitore e republikanëve mund të nënkuptojë implementimin e politikave inflacioniste. Aksionet e përfunduan tetorin në nivele më të ulëta, mes pasigurisë përpara zgjedhjeve presidenciale dhe dyshimeve të vazhdueshme për rrugën e normave të interesit.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit të Qendrueshëm Raiffeisen Solid dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të perfutur një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat jo të zakonshme të krijuara perkohesisht në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Komenti i Menaxherit të fondit Kryesor mbi zhvillimet e tregjeve financiare gjatë Tetorit

Tregjet ndërkombëtare të aksioneve ishin të paqëndrueshme në tetor. Tregjet e obligacioneve qeveritare në SHBA dhe Evropë humbën terren në tetor. Pas sinjaleve të një tendence disi më pozitive ekonomike në SHBA, investitorët në Evropë gjithashtu filluan të rishikojnë pritshmëritë e tyre për agresivitetin e uljes së normave të interesit nga BQE në muajt e ardhshëm.

Fondi kryesor investon duke siguruar diversifikim të gjerë në obligacione dhe aksione të kompanive dhe qeverive që respektojnë kriteret e qëndrueshmërisë. Alokimi në aksione aktualisht është rreth 20% dhe zotërimet në obligacionet e korporatave kanë ndryshuar pak, duke mbetur në rreth 40%.

Zhvillimet në muajt e ardhshëm do të varen kryesisht nga masat e ndërmarra nga bankat qendrore në vijim, nga rritja ekonomike në SHBA dhe Europë, si dhe nga rezultati i zgjedhjeve në SHBA. Fokusi po mbahet edhe të gjeopolitika.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit Furnizues. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit Furnizues gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.

Dokumentacionin e fondit Kryesor mund ta gjeni në gjuhën angleze dhe gjermane duke klikuar si më poshtë:

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>